



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**10.01.2018, Prishtinë,
Ref:01.12.2017\586-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në mbledhjen e bordit të mbajtur më 19 dhjetor 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Aferat multimilionëshe ia prenë krahët Shpendit të inkriminuar", botuar më 01 nëntor 2017, dhe nxori këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

A R S Y E T I M I

Në artikull thuhet se Shpend Ahmeti u ka dhënë leje ndërtimore në mënyrë ilegale Devollëve. Kjo kompani quhet "bandë". Në ankesë thuhet se për asnjërën nga këto shpifje dhe dezinformata, gazeta nuk ka dhënë mbështetje të argumentuar.

KMShK, pasi e shqyrtoi ankesën dhe artikullin e lartëpërmendur vendosi se gazeta ka bërë shkelje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës), pasi që ka botuar vetëm prononcimet e një grupi të analistëve të saj, pa i mundësuar edhe kompanisë Devolli që të prononcohet ose ndonjë organi kompetent apo ndonjë burimi të pavarur në mënyrë që të krijohej një pasqyrë më e qartë rreth temave që i ka shqyrtuar në artikull. Në këtë mënyrë edhe lexuesi do të përfitonte duke pasur parasysh se do të krijohej një spektër i gjerë i pikëpamjeve dhe fakteve në të mirë të së vërtetës.

Gjithashtu, KMShK konstatoi se gazeta nuk ka botuar asnjë reagim të palës tjetër për çka ka qenë e obliguar sipas Kodit të Mediave të Shkruara, me çka do të përmbushej obligimi që del nga Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur) i Kodit të Mediave të Shkruara.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opinioni.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës